



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HIMARË
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 4268 prot.

Himarë, më 12.06. 2026

VENDIM

Nr. 28, Datë 04.06. 2026

PËR

“DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.39, DATË 20/12/2024 “PËR KRIJIMIN E NDËRMARRJES SË SHËRBIMEVE PUBLIKE HIMARË SI INSTITUCION NË VARËSI TË BASHKISË HIMARË”

Mbështetur në nenet 34,40,41,45,55 të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjin nr.9936, datë 26.08.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, kreut III nenet 10-20, kreut IV nenet 20-29, kreut VII nenet 39-40 të ligjit nr.68/2017 “Për financat e qeverisjes vendore”, ligjin nr.10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, udhëzimin nr. 2 datë 06.02.2012 të Ministrisë së Financave “Mbi procedurat standarte të miratimit të buxhetit”, VKM -në nr.328, datë 31.5.2023, “Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore” (i përditësuar). Me propozimin e Kryetarit të Bashkisë Himarë, Këshilli Bashkiak Himarë në mbledhjen e datës 04.06.2026, miratoi me 14 (katërmëdhjetë) vota pro, 1 (një) kundër, 3 (tre) abstenim dhe si më poshtë:

VENDOSI:

Në vendimin nr.39, datë 20/12/2024 “Për krijimin e Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike Himarë si institucion në varësi të Bashkisë Himarë”, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Në pikën 1: “Të miratojë krijimin e NSHP Himarë (Ndërmarrja e Shërbimeve Publike Himarë), si institucion në varësi të Bashkisë Himarë. Detyrat kryesore institucionale e funksionale të këtij instiucioni do të jenë si më poshtë vijon:” bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Pas shkronjës (n) shtohen shkronjat (nj), (o) dhe (p) me këtë përmbajtje:

nj. Të administrojë dhe mirëmbajë vendet e depozitimit të mbetjeve të ngurta dhe inerteve në territorin e Bashkisë Himarë, si dhe të organizojë sistemin, grumbullimin, transportimin dhe trajtimin e tyre, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

o. Të ketë të drejtë të lidhë marrëveshje bashkëpunimi, kontrata shërbimi apo forma të tjera bashkëpunimi me subjekte publike ose private për depozitimin, administrimin, transportin, përpunimin, riciklimin dhe menaxhimin e mbetjeve të ngurta dhe inerteve.

p. Të zbatojë masa dhe politika për reduktimin e ndotjes nga mbetjet e ngurta dhe inertet, si dhe për përmirësimin e administrimit mjedisor dhe rehabilitimin e zonave të ndotura në territorin e Bashkisë Himarë.

2. Ngarkohet Ndërmarrja e Shërbimeve Publike Himarë me zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi sipas Ligjit Nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” neni 55, pika 6.

KRYETARI

Dhimitër Kapaj

